



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, 19 dhjetor 2022
Nr. ref.:RK 2097/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI42/21

Parashtrues

Arsim Isufi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit, Rev.nr.288/2020, të 1 tetorit 2020, të Gjykatës Supreme të
Republikës së Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Arsim Isufi me vendbanim në fshatin Keqekollë, Komuna e Prishtinës, i cili përfaqësohet nga avokati Artan Qerkini (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [Rev.nr.288/2020] e 1 tetorit 2020, të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [Ac.nr. 4976/2018] e 4 dhjetorit 2019, të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin në vijim: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [C.nr.1823/17] e 28 shtatorit 2018, të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesi i kërkesës, Aktgjykimin e kontestuar e kishte pranuar më 30 tetor 2020.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar përmes së cilit, sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës, i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) dhe nenet 7 dhe 10 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut (në tekstin në vijim: DUDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] e 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës

6. Më 24 shkurt 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 26 shkurt 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha, dhe Radomir Laban (anëtarë).
8. Më 3 mars 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 3 mars 2021, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës dhe të njëjtës i ofroi një kopje të saj.
10. Më 3 mars 2021, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë, që të njoftojë Gjykatën lidhur me datën kur parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme.
11. Më 9 mars 2021, Gjykata Themelore i dorëzoi Gjykatës fletëkthesën që tregon se parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin e kontestuar e kishte pranuar më 30 tetor 2020.
12. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit

të Gjykatës KK-SP 71-2/21 u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares së Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.

13. Më 8 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama Hajrizi përmes Vendimit [Nr.K.SH. KI42/21] caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi, Gjyqtar Raportues në vend të Gjyqtares Gresa Caka Nimani.
14. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
15. Më 16 nëntor 2022, Gjykata shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

16. Nga shkresat e lëndës rezulton që parashtruesi i kërkesës ishte i punësuar në Policinë e Kosovës, në pozitën zyrtar për sigurimin e objekteve dhe personaliteteve, në Prishtinë. Më 7 janar 2012, Ministria e Punëve të Brendshme (e cila e kishte statusin e palës së paditur) i ishte drejtuar Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Policisë duke e njoftuar se parashtruesi i kërkesës nuk ishte paraqitur fare në detyrë dhe me këtë rast kishte kërkuar që të inicohet procedura përkatëse disiplinore për mosparaqitje në detyrë.
17. Më 12 janar 2012, Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Policisë në Prishtinë, morri vendim që parashtruesit të kërkesës ti shqiptohet vërejtje me shkrim për shkak se i njëjti kishte munguar tre ditë nga puna.
18. Më 21 mars 2021, parashtruesi i kërkesës ishte ftuar në intervistë ku kishte deklaruar se nuk ka plotësuar asnjë formular të pushimit me arsyetimin se në mënyrë të pandërprerë ishte përkujdesur për familjen e tij.
19. Më 30 gusht 2012, pas shqyrtimit të të gjeturave të raportit përfundimtar të hetimit [26 mars 2012], ku ishte vërtetuar se parashtruesi i kërkesës nga 14 janari 2012 deri më 20 mars 2012, nuk ishte paraqitur në punë për 50 ditë, duke mos plotësuar asnjë formë të pushimit për këtë periudhë ndërsa te mbikëqyrësi i tij nuk ka dërguar asnjë raport mjekësor apo shenjë mjekësore me te cilat do të arsyetonte mungesat e tij në punë, u shqiptua Vendimi [166/KBD/2012] i Komisionit Disiplinor për Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës.
20. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës dorëzoi ankesë kundër vendimit të lartcekur, e cila u refuzuar me 22 tetor 2012, nga Vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm i Policisë, i cili konfirmoi mbetjen në fuqi të Vendimit [166/KBD/2012] të 30 gushtit 2012, të Komisionit Disiplinor, për masën e shqiptuar disiplinore ndërprerje e marrëdhënies së punës.
21. Më 22 qershor 2015, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C.nr.2025/13]: (i) refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës përmes së cilës kishte kërkuar që të detyrohet Ministria e Punëve të Brendshme që të anuloi si të kundërligjshëm Vendimin [166/KBD/2012] e 30 gushtit 2012, të Komisionit Disiplinor, si dhe Vendimin [1265-DPPK-01/1265/2012] e 22 tetorit 2012, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, si dhe kthimin në vendin e punës me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës duke përfshirë edhe kompenzimin në pagë që nga 1 shtatori 2012 e deri më 30 prill 2015, ndërsa prej kësaj

date t'ia paguaj pagën prej 675,30 euro deri në kthimin e tij në punë si dhe shpenzimet e procedurës.

22. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës dorëzoi ankesë kundër Aktgjykimit të lartcekur për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të priset dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.
23. Më 10 korrik 2017, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [CA.nr. 4037/2015] aprovoi si të bazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, ndërsa Aktgjykimi [C.nr.2025/13] i Gjykatës Themelore i datës 9 qershor 2015, priset, dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në riprocedurë dhe vendosje. Në arsyetimin e saj ndër të tjera, Gjykata e Apelit theksoi që *"e paditura – Ministria e Punëve të Brendshme nuk e ka zbatuar parimin e legalitetit e që është i obliguar edhe në këto procedura sepse ndaj paditësit ka shqiptuar masën për shkeljen e cila nuk është paraparë me dispozita të Ligjit për Polici nr.03/L-035 përkatësisht neni 46 i tij dhe nuk e ka zbatuar procedurën që është paraparë me dispozita të nenit 45 të atij Ligji, çka do të thotë se ka dhënë vendim të kundërligjshëm ndaj paditësit sepse sipas Ligjit për Polici nr.03/L-035 në procedurat disiplinore për zyrtaret policore dhe për të punësuarit e tjerë konkretisht neni 45.1 ka përcaktuar decidivisht se akuzat për shkelje të rënda disiplinore, ku përfshihet zyrtari policor ose ndonjë punëtor tjetër i Policisë, përveç pozitave të larta, do t'i hetojë Inspektorati Policor i Republikës së Kosovës në përputhje me procedurat e përshkruara në ligjin në fuqi dhe në aktet nënligjore"*.
24. Në procedurën e përsëritur, parashtruesi i kërkesës theksonte që nuk ka kryer shkelje disiplinore e cila i vihet në barrë, duke pohuar se mungesa e tij nga puna ka qenë e arsyeshme dhe atë kryesisht për shkaqe familjare, si sëmundja e nënës, lindja e binjakëve, gjendja jo e mirë shëndetësore e bashkëshortes pas lindjes së fëmijëve, e që të gjitha këto paraqesin arsye të mjaftueshme për mungesën e paditësit në punë me qëllim të përkujdesjes për familjen.
25. E paditura – Ministria e Punëve të Brendshme në procedurën e rigjykimit, ka përsëritur se mungesa e paditësit për 50 ditë nga puna është e paarsyeshme pasi që parashtruesi i kërkesës nuk i ka respektuar procedurat dhe nuk e ka nënshkruar asnjë formular të pushimit. Ka shtuar se i njëjti edhe më parë ka qenë subjekt i hetimit dhe në 9 raste është gjetur përgjegjës për shkelje disiplinore. Ka përsëritur që vendimi për shqiptimin e masës disiplinore - largim nga puna është marrë pas zhvillimit të një procedure të drejtë dhe ligjore dhe që masa disiplinore është shqiptuar nga organi kompetent.
26. Më 28 shtator 2018, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C.nr.1813/17]: (i) aprovoi në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës; (ii) anuloi si të kundërligjshme Vendimin [nr. 166/KBD/2012] e 30 gushtit 2012, të Komisionit Disiplinor, si dhe Vendimin [nr. 1265-DPPK-01/1265/2012] e 22 tetorit 2012, e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë; (iii) detyroi të paditurën Ministria e Punëve të Brendshme- që parashtruesin e kërkesës ta kthej në vendin e punës me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës duke përfshirë edhe kompensimin në pagë që nga data 1 shtator 2012 e deri më 30 prill 2015 shumë prej 12,417.74 €, në emër të kamatës për të njëjtën periudhë në shumë prej 492.08 euro dhe që ti paguaj në trustin pensional në emër të paditësit shumë prej 1,378 € në emër të kontributeve pensionale si dhe ta paguaj tatimin në pagë në shumë prej 675.30 euro, ndërsa prej datës 1 maj 2015 deri 31 qershor 2018 arrin vlera për tërë periudhën kontestuese në shumë prej 18.712.00 euro duke përfshirë edhe kamatën në këtë shumë për 12 muajt e fundit prej 249 € që gjithsejti bëjnë 18.961.00 € për trust për kontribute prej 20.90 € dhe tatim në pagë shumen prej 1,142 €, si dhe (iv) detyrohet e paditura që ti kompenzoj edhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 2,152.00 €, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

27. Më 30 tetor 2018, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [C.nr.1823/17] (i) përmirësoi Aktgjykimin e kësaj gjykate [C.nr. 1823/17] i 28 shtatorit 2018, dhe ashtu që në hyrje dhe fund të këtij aktgjykimi në vend të numrit të lëndës 1813/17 duhet të jetë numri 1823/17; (ii) Pjesët tjera të aktgjykimit mbesin të pandryshuara; (iii) Ky aktvendim është pjesë përbërëse e Aktgjykimit [C.nr.1823/17] i 28 shtatorit 2018.
28. Më 10 tetor 2018, e paditura- Ministria e Punëve të Brendshme të cilën e përfaqësonte Avokatura Shtetërore, parashtoi ankesë kundër Aktvendimit të lartcekur, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Gjithashtu më 15 tetor 2018, e paditura dorëzoi parashtrësë për plotësimin e ankesës së 10 tetorit 2018 me arsyetim të zgjeruar.
29. Më 13 nëntor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi përgjigje në ankesë me propozimin që ankesa e të paditurës të hudhet poshtë si e palejueshme ose që të refuzohet si e pabazuar.
30. Më 4 dhjetor 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac.nr. 4976/2018] miratoi ankesën e palës së paditur Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore [C.nr.1823/2017] të 28 shtatorit 2018 dhe gjykoi si në vijim: *"refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit Arsim Isufi, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit të Komisionit disiplinor [nr.166/KBD/2012] të 30 gushtit 2012; Vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë [nr.1265-DPPK – 01/1265/2012] të 22 tetorit 2012 dhe detyrimin e të paditurës që parashtruesin e kërkesës ta kthejë në vendin e punës me të gjitha të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, duke përfshirë edhe kompensimin e pagave nga data 01 shtator 2012, e derisa të ekzistojnë kushtet ligjore, si kërkesë e pabazuar"*.
31. Më 28 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
32. Më 1 tetor 2020, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev.nr. 288/2020] refuzoi si të pabazuar revizionin e paditësit, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [Ac.nr.4976/2018] të 4 dhjetorit 2019.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

33. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktvendimit të kontestuar, i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së si dhe nenet 7 dhe 10 të DUDNJ-së.
34. Fillimisht parashtruesi i kërkesës pretendon që Vendimi i kontestuar nuk i përmbush premisat e një *vendimi të arsyetuar gjyqësor*. Parashtruesi i kërkesës thekson se e drejta për të iu drejtuar gjykatës ka për qëllim t'u garantoj palëve në një proces, të drejtën për t'u dëgjuar dhe për ti vendosur palët në çdo rast në pozita të barabarta para gjykatës.
35. Parashtruesi i kërkesës thekson se në vendimin e Gjykatës Supreme nuk është dhënë asnjë arsyetim i gjykatës, se pse kërkimi i palës së paditur është rrëzuar nga gjykata, pse nuk qëndrojnë pretendimet e palës paditëse, nuk është paraqitur asnjë arsyetim për sa i takon bazës ligjore të pretendimeve ligjore dhe asaj se ku mbështetet gjykata në vendimin e saj se këto pretendime nuk duhet adresuar.
36. Sipas parashtruesit të kërkesës, në procedurën civile të zhvilluar në gjykatat e rregullta, kontestuese ka qenë nëse ai e kishte arsyetuar mungesën nga puna me dokumentacionin

mjekësor në lidhje me gjendjen shëndetësore të bashkëshortes dhe fëmijëve të tij. Pra, sipas tij Gjykata Supreme nuk ka dhënë përgjigje në çështjet kryesore për zgjidhjen e drejtë të çështjes kontestimore, të tilla si pesha juridike e dokumentacionit mjekësor i cili vërtetonte gjendjen shëndetësore të bashkëshortes dhe fëmijëve të parashtruesit dhe se ky dokumentacion a ishte marrë parasysh nga Komisioni Disiplinor i Policisë me rastin e vendosjes për përgjegjësinë disiplinore të parashtruesit, rrjedhimisht në rastin konkret as që mund të bëhet fjalë për një vendim i cili plotëson standardet e vendimit të arsyetuar gjyqësor.

37. Në rastin në fjalë Gjykata Supreme nuk ka trajtuar pretendimet vendimtare për epilogun e çështjes e të prezantuara në Revizion, por vetëm ka konfirmuar qëndrimet juridike të Gjykatës së Apelit, pa hyrë fare në thelbin e pretendimeve të shprehura në mjetin e jashtëzakonshëm juridik.
38. Parashtruesi i kërkesës thekson që me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [Ac.nr. 4976/2018] të 4 dhjetorit 2019, është cenuar (ii) *parimi barazisë së armëve*, sepse Parashtruesi është vendos në pozitë dukshëm më të pabarabartë se pala e paditur Ministria e Punëve të Brendshme, ngase kësaj të fundit i është lejuar paraqitja e plotësimit të ankesës pas skadimit të afatit ligjor për parashtrimin e saj.
39. Parashtruesi i kërkesës thekson se pala e paditur- Ministria e Punëve të Brendshme, kishte paraqitur ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore fillimisht më 12 tetor 2018, pa arsyetim të shkaqeve për ankimim. Mungesën e arsytimit e arsyeton me gjoja ngarkesën e Avokaturës Shtetërore me volum të madh të punës dhe me pranim të numrit të madh të lëndëve ngase përfaqëson te gjithë Qeverinë e Kosovës, dhe paralajmëron se arsyetimin me te zgjeruar do ta jep ne një afat sa më të shkurtër. Arsyetimin më të zgjeruar të ankesës e paditura e ka dhënë me parashtrësën për plotësim të ankesës të cilën në gjykatë e kishte dorëzuar me datë 15.10.2018. Ndërsa parashtruesi i kërkesës përmes përgjigjes së dhënë në ankesë [13 nëntor 2018] theksoi që ankesa e paraqitur nga pala e paditur ishte e pasafatshme.
40. Sipas parashtruesit të kërkesës, argumentet e lartcekura (Përgjigja në ankesë, 13 Nëntor 2018) nuk janë paraqitur nga parashtruesi në Revizion, sepse sipas nenit 214 të LPK-së Revizioni mund të paraqitet vetëm për shkak të: - Shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 188 të këtij ligji e cila është bërë në procedurën e gjykatës së shkallës së dytë; - Për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale; - Për shkak të tejkalimit të kërkesëpadisë, po që se kjo parregullsi është bërë në procedurën e zhvilluar në gjykatën e shkallës së dytë.
41. Në vijim, parashtruesi i kërkesës thekson se moshudhja e ankesës nga Gjykata e Apelit kishte efekt të drejtpërdrejtë në të drejtat e tij, sepse në rast se ankesa e MPB-së do të hudhej poshtë, Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë për kthimin e tij në punë do të bëhej i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm.
42. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që: (i) Kërkesa e tij të shpallet e pranueshme; (ii) të konstatohet se ka pasur shkelje të nenit 24, në lidhje me nenin 3 dhe nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të Nenit 6 të KEDNJ-së dhe neneve 7 dhe 10 të DUDNJ-së; (iii) ta deklarojë të pavlefshëm, Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, [Ac.nr.4976/2018], të 4 dhjetorit 2019 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Rev.nr.288/2020], të 1 tetorit 2020; (iv) ta kthejë Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit për rivendosje në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykatë, dhe/ose; ta kthejë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme për rivendosje në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykatë.

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

- 1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
- 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*
- 3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.*

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

- 1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
- 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*
- 3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.*

Ligji Nr. 03/L-035 për Policinë

Neni 45

Procedurat disiplinore për zyrtarët policorë dhe për të punësuarit e tjerë

45.1 Akuzat për shkelje të rënda disiplinore, ku përfshihet zyrtari policor ose ndonjë punëtor tjetër i Policisë, përveç pozitave të larta, do t'i hetojë Inspektorati Policor i Republikës së Kosovës në përputhje me procedurat e përshkruara në ligjin në fuqi dhe në aktet nënligjore.

45.2 Inspektorati do t'i raportojë të gjeturat e veta te Komisioni për Emërime të Larta dhe Disiplinë në Polici i cili përcakton se a është kryer ndonjë veprë disiplinore dhe në rast se vepra disiplinore është kryer, duhet t'i rekomandojë Drejtorit të Përgjithshëm masat disiplinore që duhen të ndërmerren.

45.3 Drejtori i Përgjithshëm shqipton masën disiplinore, duke i marrë në konsideratë rekomandimet e Komisionit.

45.4 Kundër vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm mund të bëhet ankesë te Ministri.

Vendimi i Ministrit do të jetë vendim përfundimtar administrativ dhe mund t'i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor vetëm nga gjykata kompetente.

45.5 Shkeljet e lehta disiplinore, ku përfshihet zyrtari policor ose ndonjë punëtor tjetër i Policisë, përveç pozitave të larta, do t'i hetojë Njësiti i hetimeve të brendshme të Policisë në përputhje me procedurat e përshkruara në ligjin në fuqi dhe në aktet nënligjore. Njësiti i Standardeve Profesionale do t'i raportojë të gjeturat e veta të Komisionit të Brendshëm Disiplinor të Policisë, i cili do të përcaktojë se a është kryer ndonjë shkelje disiplinore dhe, në rastet kur shkelja disiplinore është kryer, shqipton masën disiplinore, duke marrë në konsideratë rekomandimet e Njësitet të hetimeve të brendshme.

5.6 Kundër vendimit të Komisionit të Brendshëm Disiplinor mund të ushtrohet ankesë në Komisionin për ankesa dhe shpërblime të Policisë. Vendimi i Komisionit të ankesave do të jetë vendim përfundimtar administrativ dhe mund t'i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor vetëm nga gjykata kompetente.

Neni 46 **Shkeljet e rënda disiplinore**

Zyrtarët policorë dhe stafi civil bëjnë shkelje të rëndë disiplinore nëse ai/ajo kryen, tenton të kryejë, ndihmon ose nxit tjetrin ta kryejë njëren nga veprimet e mëposhtme:

- a) sjellja e rëndë diskredituese;
- b) mosbindja e rëndë;
- c) zbulimi i pavend dhe i rëndë i informatave;
- d) korrupsioni;
- e) shkelja e rëndë e autorizimit;
- f) përdorimi i pavend i armës;
- g) përdorimi i tepërt i forcës;
- h) dëmtimi i rëndë i pasurisë së Policisë;
- i) përdorimi i alkoolit ose i substancave të tjera intoksikuese;
- j) ngacmimi seksual gjatë shërbimit;
- k) veprimet diskriminuese në bazë të moshës, gjinisë, orientimit seksual si dhe përkatësisë etnike dhe fetare;
- l) keqpërdorimi dhe shfrytëzimi seksual i ndonjë personi;
- m) veprimtaria penale.

Ligji Nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës

Neni 2 **Fushëveprimi**

Objekt i veprimtarisë së IPK-së është:

1.3. hetimi dhe/ose inspektimi i incidenteve disiplinore të profilit të lartë, ku përfshihen të gjithë punonjësit e Policisë së Kosovës, siç është përcaktuar në nenin 4, paragrafi 1. nën-paragrafi 1.11 të këtij ligji.

1.4. hetimi i të gjitha shkeljeve disiplinore të supozuara të zyrtarëve policor me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe zyrtarëve policor të nivelit të lartë ekzekutiv;

Neni 32 Shfuqizimi

- 1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji për Inspektoratin Policor të Kosovës Nr.03/L-036, aktet nënligjore që burojnë prej tij si dhe të gjitha dispozitat e Ligjit për Policinë që kanë të bëjnë me IPK-në, si dhe të gjitha dispozitat tjera ligjore që bien në kundërshtim me këtë ligj.*
- 2. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, shkeljet disiplinore që paraqiten, shqyrtohen në kuadër të Policisë së Kosovës, përveç shkeljeve disiplinore, nga neni 2 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.3 si dhe 1.4 të këtij ligji.*
- 3. Të gjitha shkeljet e rënda disiplinore i nënshtrohen legjislacionit që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së saj.*
- 4. Të gjitha lëndët disiplinore në IPK të cilat janë në pritje të vendimit të gjykatës në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do t'i transferohen Policisë për procedim të mëtejshëm disiplinor.*
- 5. Të gjitha hetimet penale nga ana e Policisë të cilat janë në procedurë e sipër në kohën kur ky ligj hyn në fuqi do të mbesin në Polici gjer në përfundimin e tyre.*
- 6. Hetimet penale nga IPK ndaj punonjësve të Policisë fillojnë të zbatohen gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.*
- 7. Ministri gjatë periudhës prej gjashtë (6) muajve do të nxjerr aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji dhe deri më nxjerrjen e tyre aplikohen dispozitat ligjore në fuqi.*
- 8. Gjatë periudhës gjashtë (6) mujore do të zhvillohen kapacitetet në kuadër të personelit të IPK-së si dhe do të rekrutohet personeli i nevojshëm.*

Pranueshmëria e kërkesës

43. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
44. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
45. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit, i cili përcakton:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individidi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...".

46. Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, për të gjitha pretendimet kryesore (përveç për pretendimin për respektimin e parimit të barazisë së armëve), në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, si dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e parashikuar në nenin 49 të Ligjit. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu i ka qartësuar saktësisht të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë cenuar dhe aktet e autoriteteve publike që e konteston, në pajtim me kriteret e nenit 48 të Ligjit.
47. Gjykata sjellë në vëmendje pretendimet e parashtruesit të kërkesës se vendimet e gjykatave të rregullta i kanë shkelur atij të drejtat e garantuara me nenet kushtetuese në vijim: 3 [Barazia para Ligjit], 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, si dhe nenet 7 dhe 10 të DUDNJ.
48. Gjykata në vijim do i adresojë veç e veç secilin nga këto pretendime, që kanë të bëjnë me: (I) të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm nga neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, me theks të veçantë tek (i) parimi i barazisë së armëve; si dhe (ii) pretendimet për *vendim të paarsyetuar gjyqësor*; dhe (II) pretendimet tjera për shkelje të neneve 3 dhe 24 të Kushtetutës në lidhje me nenet 7 dhe 10 të DUDNJ-së.
49. Gjykata do t'i trajtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi, me pretendimet e ngritura duke aplikuar praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mbi bazën e të cilës Gjykata, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

(I) Pretendimet për shkelje të të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm

50. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimet e gjykatave të rregullta në rastin e tij janë në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke cenuar disa komponenta të të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm,

përkatësisht: (i) parimin e barazisë së armëve; dhe (ii) të drejtën në vendim të arsyetuar gjyqësor.

(i) Përkitazi me pretendimin për shkelje të parimit të barazisë së armëve

51. Gjykata fillimisht rikujton njërin pretendim të parashtruesit të kërkesës që përmes Vendimit të kontestuar, i është cenuar *parimi barazisë së armëve*, sepse parashtruesi është vendos në pozitë dukshëm më të pabarabartë se pala e paditur Ministria e Punëve të Brendshme, ngase kësaj të fundit i është lejuar paraqitja e plotësimit të ankesës pas skadimit të afatit ligjor për parashtrimin e saj.
52. Gjykata duke iu referuar praktikës së saj dhe të GJEDNJ-së, fillimisht rithekson se parimi i "*barazisë së armëve*" është element i një koncepti më të gjerë të një gjykimi të drejtë (shih rastin e GJEDNJ-së, *Borgers kundër Belgjikës*, kërkesa nr. 12005/86, Aktgjykim i 30 tetorit 1991, paragrafi 24).
53. GJEDNJ dhe Gjykata në praktikën gjyqësore ka theksuar se parimi i "*barazisë së armëve*", kërkon "*ekuilibër të drejtë midis palëve*" ku secilës palë i duhet dhënë mundësia e arsyeshme të paraqesë rastin e tij/saj nën kushtet që nuk do të vendosnin atë në disavantazh substancial *vis-a-vis* palës kundërshtare (shih rastet e GJEDNJ-së *Yvon kundër Francës*, kërkesa nr. 44962/98, Aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 31 dhe *Dombo Beheer B.V. kundër Holandës*, kërkesa nr. 14448/88, Aktgjykimi i 27 tetorit 1993, paragrafi 33 shih dhe referencat tjera në këtë Aktgjykim, *Öcalan kundër Turqisë* [DHM], paragrafi 140, *Grozdanoski kundër ish-RJM*, kërkesa nr. 2150/03, Aktgjykim i 31 majit 2007, shih po ashtu rastet e Gjykatës: KI230/19, me parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 8 janarit 2021, paragrafi 98; KI239/19, me parashtrues *Hakif Veliu*, Aktvendim për Papranueshmëri i 19 marsit 2021, paragrafi 112; KI52/12, parashtrues *Adije Iliri*, Aktgjykim i 5 korrikut 2013, KI103/10, parashtrues *Shaban Mustafa*, Aktgjykim i 20 marsit 2012, paragrafi 40).
54. Gjykata më tej rikujton se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së ka përcaktuar se kërkesa e barazisë së armëve, në kuptim të një ekuilibri të drejtë midis palëve, vlen në parim si për raste civile ashtu edhe për ato penale (shih rastin e GJEDNJ-së: *Dombo Beheer B.V. kundër Holandës*, Aktgjykim i 27 tetorit 1993, paragrafi 33). Gjithashtu kërkesat që rezultojnë nga e drejta për procedura kundërshtuese janë në parim të njëjtat si në çështjet civile ashtu edhe në ato penale (shih rastin e GJEDNJ-së: *Werner kundër Austrisë*, Aktgjykim i 24 nëntorit 1997, paragrafi 66).
55. Në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të parimit të barazisë së armëve, Gjykata rikujton se pas ankesës së parashtruar nga e paditura- Ministria e Punëve të Brendshme, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar përgjigje në ankesën duke kërkuar që të refuzohet ankesa pasi që parashtruesi për plotësimin e ankesës e të paditurës ishte dorëzuar pas skadimit të afatit ligjor. Megjithatë, bazuar në shkresat e lëndës nuk rezulton që pretendimi i lartcekur i parashtruesit të kërkesës (*përkitazi me dorëzimin pas afatit të parashtruesës për plotësimin e ankesës të të paditurës*), të jetë ngritur në kërkesën për revizion të parashtruar në Gjykatën Supreme.
56. Gjykata vëren se secilës palë i ishte dhënë mundësia e arsyeshme të paraqesë rastin e tij, pa e vendosur në disavantazh përballë palës kundërshtare. Rrjedhimisht, e paditura Ministria e Punëve të Brendshme e përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, parashtroi ankesë kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore, e më pas më 15 tetor 2018, si dhe e dorëzoi parashtruesi për plotësimin e ankesës së 10 tetorit 2018 me arsyetim të zgjeruar. Në anën tjetër parashtruesi kishte paraqitur kundërshtimin e tij përmes përgjigjes në ankesë të 13 nëntorit 2018, ndërsa të njëjtin nuk e kishte paraqitur në kërkesën e tij për revizion të 28 shkurtit 2020.

57. Në dritën e rrethanave të rastit konkret, Gjykata konsideron se palëve përgjatë një procedure të drejtë dhe të paanshme ju është: (i) mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; (ii) akorduar mundësia që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që ata i konsiderojnë relevante për rastin përkatës; (iii) garantuar se të gjitha argumentet dhe dëshmitë, shikuar objektivisht, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit përkatës janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat përkatëse; (iv) garantuar se faktet dhe pretendimet ligjore në vendimet gjyqësore ishin shqyrtuar dhe arsyetuar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, (v) ju është garantuar se procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta dhe jo arbitrare. (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29; dhe rastin e Gjykatës, KI131/19, cituar më lart, paragrafi 58). Gjykata thekson se në rrethanat e rastit konkret, parashtuesi i kërkesës nuk ka argumentuar se ky nuk është rasti.
58. Rrjedhimisht, ky pretendim i parashtuesit të kërkesës lidhur me shkelje të parimit të barazisë së armëve është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, prandaj kjo pjesë e kërkesës duhet të shpallet e papranueshme në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me rregullin 39 (2) të Rregullores së Punës.

(ii) Përkitazi me pretendimin për vendim të paarsyetuar gjyqësor

59. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkëljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta”.
60. Në këtë kontekst, dhe në vijim, me qëllim të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në rrethanat e këtij rasti, vlerësimit nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtuesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
61. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht rikujton që rrethanat e rastit ndërlidhen me kërkesëpadinë e parashtuesit të kërkesës, për anulimin e vendimit të Komisionit Disiplinor dhe Vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, të cilat i kishin shqiptuar dhe konfirmuar masën disiplinore ndërprerje e marrëdhënies së punës. Gjykata Themelore e kishte refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtuesit të kërkesës, të paraqitur kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme. Pas ankesës së parashtuesit të kërkesës, Gjykata e Apelit aprovoi si të bazuar ankesën e tij, duke e kthyer lëndën në rigjykim. Në procedurën e përsëritur, Gjykata Themelore e aprovon kërkesëpadinë e parashtuesit të kërkesës, duke anuluar vendimin e Komisionit disiplinor dhe Vendimin e Drejtorit të përgjithshëm të Policisë për shpërbërje të marrëdhënies së punës, si dhe kishte detyruar Ministrinë që ta kthejë parashtuesin në punë me të gjitha kompensimet përkatëse. Pas ankesës përkatëse të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Gjykata e Apelit miratoi ankesën e saj, duke refuzuar kërkesëpadinë e parashtuesit të kërkesës. Duke vepruar sipas kërkesës për revizion të parashtuesit të kërkesës, Gjykata Supreme kishin refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtueses së kërkesës. Parashtuesi i kërkesës,

konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, duke pretenduar se i njëjti ka shkelur të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me nenet 3, 24 dhe 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Në vijim Gjykata do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e pretendimeve të parashtrueses së kërkesës.

62. Në thelb, parashtruesi i kërkesës për sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, kishte ngritur pretendime për *vendim të paarsyetuar gjyqësor*. Në vijim Gjykata do ti elaborojë parimet e përgjithshme lidhur me arsyetimin e vendimit gjyqësor dhe do t'i aplikoj të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.

Parimet e përgjithshme lidhur me arsyetimin e vendimeve gjyqësore

63. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së (përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe *Tatishvili kundër Rusisë*, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në KI22/16, parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; KI87/18, parashtrues i kërkesës *IF Skadiforsikring*, Aktgjykim, i 27 shkurtit 2019, dhe KI24/17, parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim, i 27 majit 2019, KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, Aktgjykim, i 11 dhjetorit 2019; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 135).
64. Në parim, praktika gjyqësore e GJENDJ-së dhe ajo e Gjykatës Kushtetuese theksojnë se e drejta për një proces të rregullt gjyqësor përfshin të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe se gjykatat duhet “*të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet në të cilat ata bazuan vendimin e tyre*”. Megjithatë, ky detyrim i gjykatave nuk mund të kuptohet si kërkesë për një përgjigje të hollësishme në çdo argument. Shkalla në të cilën zbatohet obligimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të mbështetura në ligjin e aplikueshëm (Shih rastin e Gjykatës KI97, me parashtrues *IKK Classic*, cituar më lartë, paragrafi 45; Shih gjithashtu rastin e GJEDNJ-së *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim, i 16 dhjetorit 1992, paragrafi 33).
65. Në parim, Gjykata thekson se garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih, rastin e GJEDNJ-së, *H. kundër Belgjikës*, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53; si dhe shih rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, të cituar më lart, paragrafi 139 dhe rastin KI87/18, parashtrues *IF Skadiforsikring*, paragrafi 44).
66. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të parimit i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin në të cilat ato bazohen. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet

në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih në mënyrë të ngjashme rastet e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; dhe *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, paragrafi 42, shih, po ashtu, rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, të cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin KI87/18 *IF Skadeforsikring*, të cituar më lart, paragrafi 48). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih rastin *Moreira Ferreira kundër Portugalisë*, Aktgjykim, i 5 korrikut 2011 paragrafi 84 dhe të gjitha referencat e përdorura aty; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 137).

67. Megjithatë, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, nga gjykatat kërkohet që të shqyrtojnë dhe japin përgjigje specifike dhe të qarta në lidhje me: (i) pretendimet dhe argumentet thelbësore të palës (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Buzescu kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 67; dhe *Donadze kundër Gjeorgjisë*, Aktgjykim i 3 marsit 2006, paragrafi 35); (ii) pretendimet dhe argumentet që janë vendimtare për rezultatin e procedurës (shih, rastet e GJEDNJ-së: *Ruiz Torija kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 30; dhe *Hiro Balani kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 28); ose (iii) pretendimet në lidhje me të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih rastin e GJEDNJ-së, *Wagner dhe J.M.W.L. kundër Luksemburgut*, Aktgjykim i 28 qershorit 2007, paragrafi 96 dhe referencat në të; dhe gjithashtu shih rastin e Gjykatës, KI227/19, me parashtrues *N.T. "Spahia Petrol"*, cituar më lart, paragrafi 48).

Aplikimi i këtyre parimeve në rrethanat e rastit konkret

68. Në këtë drejtim, Gjykata do të shtjellojë nëse pretendimet e parashtrueses së kërkesës për mungesë të një vendimi të arsyetuar gjyqësor, sa i përket Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev.nr.288/2020, të 1 tetorit 2020, janë në përputhshmëri me garancitë procedurale të mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.
69. Gjykata rikujton se në Aktgjykimin [Ac.nr.4976/2018] e 4 dhjetorit 2019, të Gjykatës së Apelit, e njëjta kishte trajtuar çështjen e vërtetimit të gjendjes faktike dhe zbatimit të së drejtës materiale, duke arsyetuar si në vijim:

Ndonëse gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë gjendjen faktike, megjithë këtë ka ardhur në përfundim të gabuar se vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit është marrë nga organi i paautorizuar, për faktin se referimi në aktgjykim është herë në dispozitën e nenit 45 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Policinë, ku parashihet se organ kompetent hetues për shkeljet e rënda disiplinore të zyrtareve policor, është Inspektorati Policor i Kosovës. Mirëpo, në dhënien e vlerësimit përfundimtar në aktgjykimin e ankimuar, gjykata e shkallës së parë nuk ka pasur parasysh se këto autorizime të Inspektoratit Policor të Kosovës, kanë ndryshuar me nxjerrjen e ligjit të ri nr.03/L-231, datë 14.10.2010, i cili ligj, në nenin 32 shprehimisht ka përcaktuar që pas hyrjes në fuqi, shkeljet disiplinore që paraqiten do të shqyrtohen në kuadër të Policisë së Kosovës, përveç shkeljeve disiplinore, nga neni 2 paragrafi 1.nen-paragrafi 1.3 si dhe 1.4 të këtij ligji, e të cilat kanë të bëjnë me hetimin e incidenteve disiplinore të profilit të lartë, ku përfshihen të gjithë punonjësit e Policisë së Kosovës, respektivisht hetimin e të gjitha shkeljeve disiplinore të supozuara të zyrtarëve policor me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe zyrtarëve policor të nivelit të lartë ekzekutiv, e që në rastin konkret, këto dispozita nuk kanë mundur të aplikohen për hetimin e shkeljeve disiplinore nga ana e paditësit, për arsye

se pozita e paditësit tek e paditura nuk paraqet pozitë të profilit të lartë, gjegjësisht pozitë të nivelit të lartë menaxhues, apo të atij ekzekutiv.

Gjithashtu, kualifikimi për shkelje të rëndë disiplinore është bërë në përputhje me dispozitën nga neni 46 par.1 pika b) të Ligjit nr. 03/L-35 dhe neni 6, par. 6. 7 të Udhëzimit administrativ (për llojet e shkeljeve të rënda dhe të lehta disiplinore në Policinë e Kosovës), dhe përfundimisht, masa disiplinore e shqiptuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, është nxjerrë nga organ kompetent, ashtu siç përcaktohet me dispozitën e nenit 45 par. 3 të Ligjit për Policinë nr. 03/L-35. Prandaj nga arsyet e parashtruara me sipër dhe në mbështetje të nenit 195 par.1 pika e), lidhur me nenin 201 par.1 pika d), Gjykata e Apelit, vendosi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

70. Mbi këtë vijë argumentimi, Gjykata vë theksin edhe në arsyetimin e Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, më të cilin u refuzua kërkesa për revizion e parashtruesit të kërkesës, si në vijim:

Gjykata e shkallës së dytë drejt ka vlerësuar se në kohën kur është bërë shkelja disiplinore nga ana e paditësit dhe kur është zhvilluar procedura disiplinore ndaj paditësit, për shkelje të rënda të detyrave të punës, ka qenë në fuqi Ligji mbi Inspektoratin Policor të Kosovës (nr.03/L-231) i cili në nenin 32 shprehimisht parasheh në piken 2: "Pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji, shkeljet disiplinore që paraqiten shqyrtohen në kuadër të Policisë së Kosovës, përveç shkeljeve disiplinore, nga neni 2 par. 1 nënpar. 1.3 dhe 1.4 të këtij Ligji". Pra, sipas kësaj dispozite Inspektorati Policor heton shkeljet disiplinore të profilit të lartë, që këto dispozita nuk mund të aplikohen për hetimin e shkeljeve disiplinore nga ana e paditësit si zyrtar policor, e që nuk i përket profilit të lartë që do t'i hetonte Inspektorati Policor.

71. Për sa më sipër, Gjykata vë në pah se nenin 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ i detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk nënkupton një përgjigje të hollësishme për çdo pretendim dhe argument të palëve (Shih rastet e GJEDNJ-së: *Van de Hurk kundër Hollandës*, kërkesa nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 Prillit 1994, paragrafi 61; *García Ruiz kundër Spanjës* [DHM], cituar më lartë, paragrafi 26; *Jahnke dhe Lenoble kundër Francës*, kërkesa nr. 40490/98, Vendim për paranueshmëri i 29 gushtit 2000; *Perez kundër Francës* [DHM], kërkesa nr. 47287/99, Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81). Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata Kushtetuese (Shih rastet e Gjykatës KIO6/17, cituar më lart, paragrafi 38; KI122/16, cituar më lart, paragrafi 58; dhe KI49/19, cituar më lart, paragrafi 49).
72. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta kanë përmbushur detyrimin e tyre kushtetues për të ofruar një arsyetim të mjaftueshëm ligjor përkitazi me kërkesat dhe pretendimet e parashtruesit të kërkesës. Për rrjedhojë, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës ka përfituar nga e drejta për të pranuar vendim të arsyetuar gjyqësor, në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
73. Në lidhje me këtë, Gjykata e konsideron të rëndësishme të theksojë qëndrimin e përgjithshëm parimor se "drejtësia" që garantohet përmes nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk është drejtësi "substanciale", por drejtësi "procedurale". Në terma praktik dhe në parim, kjo drejtësi procedurale shprehet përmes procedurës kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para Gjykatës (Shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës, KI131/19, parashtrues *Sylë Hoxha*, Aktvendim për papranueshmëri i 21 prillit 2020, paragrafi 57; dhe KI49/19, cituar më lart, paragrafi 55).
74. Kjo më saktësisht nënkupton se palëve përgjatë një procedure të drejtë dhe të paanshme duhet: (i) t'u mundësohet zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit

procedural; (ii) t'u ofrohet mundësia që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që ata i konsiderojnë të rëndësishme për rastin përkatës; (iii) t'u garantohet se të gjitha argumentet dhe dëshmitë që ishin të rëndësishme për zgjidhjen e rastit përkatës janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat përkatëse; (iv) t'u garantohet se faktet dhe pretendimet ligjore në vendimet gjyqësore ishin shqyrtuar dhe arsyetuar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, (v) t'u garantohet se procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta dhe jo arbitrare (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 29; dhe rastin e Gjykatës, KI131/19, cituar më lart, paragrafi 58).

75. Gjykata arrin në përfundim se në rrethanat e rastit konkret, parashtuesi i kërkesës nuk ka argumentuar se standardet dhe garancionet e mësipërme të nenit 31 të Kushtetutës, nuk janë zbatuar. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se ky pretendim i parashtuesit të kërkesës lidhur me vendimin e paarsyetuar gjyqësor është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, prandaj kjo pjesë e kërkesës duhet të shpallet e papranueshme në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me rregullin 39 (2) të Rregullores së Punës.

(II) Në lidhje me pretendimet për shkelje të neneve 3 dhe 24 të Kushtetutës

76. Gjykata rikujton se parashtuesi i kërkesës gjithashtu pretendon: (i) *shkelje të neneve 3 dhe 24 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenet 7 dhe 10 të DUDNJ-së*. Sa i përket shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të përcaktuara me nenet e lartcekura, Gjykata rikujton se sipas praktikës së themeluar gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata e shpall kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar kur pretendimet janë “*të pambështetura apo të paarsyetuara*” kur plotësohet një nga dy kushtet karakteristike, përkatësisht;

- kur parashtuesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (Shih: në këtë drejtim, rasti i GJEDNJ-së *Trofimchuk kundër Ukrainës (vendim)* i 31 majit 2005, kërkesa nr. 4241/03; shih gjithashtu *Baillard kundër Francës (vendimi 25 shtatorit 2008, kërkesa nr. 6032/04)*;
- kur parashtuesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë provat materiale me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih rastin KI166/20, parashtues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 janarit 2021, paragrafi 42).

77. Në rastin konkret, parashtuesi i kërkesës pretendon shkelje të neneve 3 dhe 24 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenet 7 dhe 10 të DUDNJ-së, mirëpo i njëjti, nuk shpjegon specifikisht se si ka ardhur deri te shkelja e këtyre neneve të Kushtetutës dhe DUDNJ-së. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtuesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet KI175/20, me parashtues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për Papranueshmëri i 22 prillit 2021, paragrafi 81; KI166/20 cituar më lart, paragrafi 52; KI04/21, me parashtuese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për Papranueshmëri i 11 majit 2021, paragrafët 38- 39).

78. Andaj, Gjykata konstaton se sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje neneve 3 dhe 24 të Kushtetutës, në lidhje me nenet 7 dhe 10 të DUDNJ-së, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar, sepse ky pretendim cilësohet si pretendim që i takon kategorisë së pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, pasi parashtruesi i kërkesës thjesht ka cituar një dispozitë të Kushtetutës dhe KEDNJ-së, pa shpjeguar se si është shkelur ajo. Prandaj, ky pretendim është qartazi i pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundim

79. Në fund, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e papranueshme, sepse (I) pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për (i) *shkelje të parimit të barazisë së armëve* dhe (ii) Pretendimit për *Vendim të paarsyetuar gjyqësor*; shpallen të papranueshëm si qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës; si dhe (II) përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të neneve 3 dhe 24 të Kushtetutës, në lidhje me nenet 7 dhe 10 të DUDNJ-së, duhet të deklarohen si qartazi të pabazuara, sepse këto pretendime cilësohen si pretendime që i takojnë kategorisë së pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”. Rrjedhimisht pretendimet e parashtruesit të kërkesës deklarohen të papranueshëm si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit dhe rregullat 39 (2), si dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 16 nëntor 2022, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani